



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2022:059473  
Datë: 16.05.2022  
Numri i dokumentit: 03013778

C. nr.100/22

GJYKATA THEMELORE MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI, Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Jeton Zymeri, në çështjen juridike të propozuesit Sabri Hasani nga Vushtrria, rruga "Xh. U." "A. G." M. ., hyrja ., nr., të cilin e përfaqëson i autorizuari Xhafer Maliqi, avokat në Prishtinë, rruga "A.G." M. ., hyrja ., nr. ", kundër kundërshtarit të masës së përkohshme të sigurimit S. U. nga V., Rr" R. M." nr.. të cilin e përfaqëson Amir Bunjaku avokat në P., rruga "B. D.e K. .", hyrja 3, nr.4, duke vendosur sipas propozimit për caktimin e masës së sigurimit, jashtë seance më datë 16.05.2022 mori këtë:

A K T V E N D I M

I. CAKTOHET MASA E SIGURIMIT dhe i NDALOHET kundërshtarit të masës së sigurimit S. U. nga V ., Rr"R. M." nr.21, që të shes apo në çfarëdo mënyre tjetër të tjetërsoj paluajtshmërinë, e cila gjendet në vendin e quajtur V./M. Tita, e evidentuar si parcelë kadastrale me nr. të njësisë P-70202016-00054-8, me sipërfaqe prej 109 m<sup>2</sup> , tokë bujqësore, arë e klasit 2, Zona Kadastrale Vushtrri, krejt kjo e regjistruar në Certifikatën e datës 25.03.2022, deri në plotfuqishmërinë e kësaj çështje kontestimore, apo deri në ndonjë vendim tjetër të kësaj gjykate.

II. DETYROHEN Zyra Kadastrale në Komunën e Vushtrrisë dhe Shërbimi Noterial në Vushtrri, që ndalimin nga paragrafi I të këtij dispozitivi ta evidentojnë në regjistrat përkatës të tyre.

III. OBLIGOHET propozuesi S. H. që të ngrit padinë brenda afatit prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktvendimi.

IV. OBLIGOHET kundërpropozuesi i sigurimit S. U. që të autorizuarit të propozuesit t'ia paguaj shpenzimet e procedurës në shumën totale prej 748,80 euro dhe atë: në emër të përpilimit të

propozimit shumë prej 208 euro dhe për dy seanca shumë nga 270.40 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi, nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

### A r s y e t i m

Propozuesi S. H. nga V., Rr "Xh. U." nr..., të cilin e përfaqëson i autorizuari Xhafer Maliqi, avokat në Prishtinë, rruga UÇK nr. 25, me datë 29.03.2022 ka parashtruar propozim për caktimin e masës së përkohshme të sigurimit, me të cilën ka kërkuar ti ndalohet kundërshtarit të masës së përkohshme të sigurimit S. U. nga . Rr"R. M." nr.21, që të shes apo në çfarëdo mënyre tjetër të tjetërsoj paluajtshmërinë, e cila gjendet në Vushtrri në vendin e quajtur V./M.Tita, e evidentuar si parcelë kadastrale me nr. të njësisë P-70202016-00054-8, me sipërfaqe prej 109 m<sup>2</sup>, tokë bujqësore, arë e klasit 2, Zona Kadastrale V. krejt kjo e regjistruar në Certifikatën e datës 25.03.2022, duke theksuar se janë plotësuar kushtet për caktimin e të njëjtës, pasi që pa caktimin e masës së përkohshme të sigurimit ekziston rreziku që kundërshtari i masës së përkohshme të sigurimit të shes, tjetërsojë apo të kryej ndonjë veprim në paluajtshmërinë kontestuese, me ndërrimin e pronarëve apo uljen e vlerës së paluajtshmërisë, e që do të kishte pasoja të pariparueshme për propozuesin e masës së përkohshme të sigurimit.

Gjykata me Aktvendimin C. nr.100/22 të datës 08.04.2022 e ka aprovuar propozimin e palës paditëse dhe e ka caktuar masën e përkohshme. Kundër të njëjtit aktvendim me datën 15.04.2022 ka ushtruar kundërshtim i autorizuari i kundërshtarit të masës së sigurimit av. Amir Bunjaku nga Prishtina, me arsye të paraqitura më afër si në kundërshtim.

Lidhur me këtë kundërshtim, gjykata ka caktuar seancën shqyrtuese cila është mbajtur me datën 21.04.2022. Me propozimin e të autorizuarit të propozuesit të masës së sigurimit, gjykata me datë 27.04.2022 ka mbajtur seancën e radhës, në të cilën kanë dëgjuar propozuesi i masës, kundërshtari i masës dhe dëshmitari B. M.

Në këtë seancë kanë prezantuar propozuesi dhe kundërpropozuesi, të autorizuarit e tyre dhe dëshmitari B. M..

I autorizuari i propozuesit av. Xhafer Maliqi nga Prishtina ka deklaruar se mbetet në tërësi në thëniet e mëparshme nga seanca e kaluar.

Propozuesi S. H. ka deklaruar se parcelën me shtëpi e ka blerë në vitin 2004 nga B. M. në gjendje siç është edhe tani, se para 3 ose 4 muajve iu ka ofruar mundësia për dhënien e parcelës për

ndërtim të lartë, por e ka kuptuar që sipërfaqja prej 1 ari e 9 metra në të cilën përfshihet edhe gjysma ose pak më shumë se gjysma e shtëpisë, evidentohet në emër të kundërshtarit të masës Skënder Uka dhe deklaratimet e tjera më gjerësisht si në procesverbalin e kësaj seance.

I autorizuari i kundërshtarit të masës av Amir Bunjaku nga P. ka deklaruar se mbetet në pranë përgjigjes të dhënë kundër aktvendimit për caktimin e masës së si dhe deklarimeve në seancën e kaluar.

Kundërshtari i masës së sigurimit S. U. ka deklaruar se diku në vitin 2004 me B. M. kanë pasur marrëveshje për ndërrimin e parcelave, njëra prej 4 ari e 30 metra dhe tjetra prej 4 ari e 7 metra dhe të njëjtit në atë kohë ia ka treguar gjendjen siç është edhe tani, se i ka treguar B. se sipas fletës poseduese janë 4 ari e disa metra, por ndoshta fizikisht nuk është kjo sipërfaqe sepse shtëpitë i kanë bashkë me agjallarët e tij dhe deklarimet tjera më gjerësisht si në procesverbalin e kësaj seance.

Dëshmitari B. M. ka deklaruar se në vitin 2004 i kanë ndërruar parcelat me kundërshtarin e masës së sigurimit S. U.. Gjendja e parcelës ka qenë e njëjtë si tani, e rrethuar me mure. Pastaj këtë parcelë ia ka shitur propozuesit S. H. ndërsa sa i përket bartjes së pronësisë, të njëjtin e ka udhëzuar që të kontaktoj me kundërshtarin e masës-S. U. dhe deklarimet tjera më gjerësisht si në procesverbalin e kësaj seance.

Gjykata me Aktvendimin C. nr.100/22 të datës 28.04.2022 e ka obliguar propozuesin S. H. që në emër të garancisë për masën e propozuar të sigurisë, brenda afatit prej 3 ditësh, t'i deponojë pranë arkës së kësaj gjykate, përkatësisht në xhirollogarinë e Këshillit Gjyqësor të Kosovës për depozita civile, shumën në lartësi prej 5.000 euro. Propozuesi brenda afatit të përcaktuar e ka bërë pagesën e shumës së caktuar nga gjykata dhe ia ka dorëzuar gjykatës urdhërpagesën.

Gjykata shqyrtoi me kujdes propozimin për masën e sigurisë si dhe deklarimet e palëve lidhur me caktimin e tani masës së sigurimit në seancën shqyrtuese të mbajtur me datën 27.04.2022 , dhe pas analizimit të provave materiale të cilat gjenden në shkresat e lëndës, gjykata ka ardhur në përfundim se propozimi i palës paditëse për caktimin e masës së sigurimit, është i bazuar.

Me nenin 297 të LPK-së, është paraparë se “Masa e sigurimit mund të caktohet në qoftë se propozuesi i sigurimit e bënë të besueshme ekzistimin e kërkesës apo të drejtës subjektive të tij, dhe në qoftë se ekziston rreziku se pa caktimin e masës së këtillë pala kundërshtarë do të mund të pamundësonte apo vështirësonte dukshëm realizimin e kërkesës, sidomos me tjetërsimin e

pasurisë së vet, me fshehjen e saj, me ngarkimin apo me ndonjë mënyrë tjetër, me të cilën do ta ndryshonte gjendjen ekzistuese të gjërave, ose në ndonjë mënyrë tjetër do të ndikonte negativisht në të drejtat e propozuesit të sigurimit”. Po ashtu me nenin 300 të LPK-së është paraparë se për sigurimin e kërkesës së drejtuar kah sendi i caktuar apo kah një pjesë e tij mund të caktohen disa lloje të masave të sigurimit, ndërsa me nenin 304.3 të LPK-së, është përcaktuar se, mes tjerash, “Propozuesi në propozimin e tij duhet t’i tregojë edhe faktet mbi të cilat mbështetet kërkesa e tij, si dhe të propozohen mjetet provuese me të cilat mund të provohen pretendimet e parashtruara në propozim”, si dhe që këto “mjete provuese t’ia bashkëngjisë propozimit”.

Gjykata pas analizimit dhe vlerësimit të provave të cilat gjenden në shkresat e lëndës, erdhi në përfundim se propozimi i propozuesit për caktimin e masës së sigurimit është i bazuar nga fakti se ekziston rreziku që pa caktimin e masës së sigurisë do të vështirësohet dukshëm realizimi i kërkesës nga propozuesi, i paraparë me nenin 297.1 pika b), ekzistimin e rrezikut real se pa caktimin e masës së propozuar pala paditëse do të pësojë dëm të pariparueshëm. Duke u nisur nga propozimi i propozuesit me të cilin ka kërkuar që të t’i ndalohej kundërshtarit të masës që të mos e shes apo në çfarëdo mënyre tjetër të tjetërsoj paluajtshmërinë, e cila gjendet në vendin e quajtur V/M.T, e evidentuar si parcelë kadastrale me nr. të njësisë P-70202016-00054-8, me sipërfaqe prej 109 m<sup>2</sup>, tokë bujqësore, arë e klasit 2, Zona Kadastrale Vushtrri, krejt kjo e regjistruar në Certifikatën e datës 25.03.2022, rrjedh fakti se nga ky propozim dhe provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, vërehet se ka rrezik se pa caktimin e masës së këtillë pala kundërshtare do të mund të pamundësojë apo vështirësojë dukshëm realizimin e kërkesës, sidomos me tjetërsimin e pasurisë së vet, me fshehjen e saj, me ngarkimin apo me ndonjë mënyrë tjetër, me të cilën do ta ndryshonte gjendjen ekzistuese të gjërave, ose në ndonjë mënyrë tjetër do të ndikonte negativisht në të drejtat e propozuesit të sigurimit.

Lidhur me shpenzimet e procedurës, gjykata vendosi përshtatshmërisht konform nenit 452 par.1 të LPK-së.

Bazuar në të lartcekurat, gjykata e aprovoi propozimin e palës paditëse për caktimin e masës së sigurimit, pasi vlerësoi se janë plotësuar kushtet ligjore të parapara me nenin 297.1 pika a) dhe b) e LPK-së, për tu caktuar një masë e tillë.

Nga sa u tha më lartë e konform dispozitave ligjore të parapara me nenin 297, nenin 306 par. 3 lidhur me nenin 142.5 të LPK-së, kjo gjykatë vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Numri i lëndës: 2022:059473  
Datë: 16.05.2022  
Numri i dokumentit: 03013778

GJYKATA THEMELORE MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI

Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni-Civil

C. nr.100/22, datë 16.05.2022

Gjyqtari  
Jeton Zymeri

KËSHILLË JURIDIKE: Pala e pa kënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 7 dite pas ditës së pranimit të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.